

KONTRATA

Në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14 Prill 2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", neni 119/5, si dhe Ligjit 9879 dt.21 Shkurt 2008 "Per Titujt", neni 6 neni 13, 126 lidhet kjo kontrate:

NDERMJET:

"QËNDRËS SË RREGJISTRIMIT TË AKSIONEVE" – SH.A., me seli ne Tirane, Rr. "Presidenti George W. Bush" Nr.13, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, me vendimin No.14253, date 21.03.1996, më poshtë i quajtur **"Rregjistruesi"**, përfaqësuar nga Z.Genard Kastrati, Asministrator i Shoqërisë

DHE

Shoqërisë "_____" sh.a. **Tirane**, person juridik, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me vendimin No._____, date_____, që më poshtë do të quhet **"Emetuesi"**, përfaqësuar nga Z._____, Drejtor i Përgjithshem i Shoqërisë;

Të dy palët në këtë kontratë ranë dakord përsa vijon më poshtë:

I. DETYRIMET E RREGJISTRUESIT

- 1.1 Krijimin dhe mbajtjen e Rregjistrimit të Aksionereve (bazuar kjo dhe në Rregulloren e miratuar nga Keshilli Mbikqyres I Rregjistruesit) për llogari të Emetuesit. Ky regjistër do të mbahet në dy kopje me vlerë të njëjtë, njëra në formatin kompjuterik dhe tjetra në regjistrin në letër.
- 1.2 Rregjistruesi në çdo kohë pajis Emetuesin me ekstrakt në çdo moment përkundëjt pagesës së kryer në përputhje me Aneksin 1 të kësaj kontrate (ku përmbledhet lista e Tarifave të Sherbimeve).

- 1.3 Rregjistruesi kryen për llogari të Emetuesit lajmërimin e aksionerëve të tij për mbledhjen e Asamblesë sa herë që Emetuesi e gjykon të nevojshme dhe përkundrejt pagesës së kryer në përputhje me listen e tarifave të shërbimeve. Lajmërimi i mbledhjeve të Asamblesë do të kryhet me anë të shërbimit postar. Njoftimet e aksionerëve për mbledhje duhet të përgatiten jo më vonë se 3 (tri) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga ana e Emetuesit. Ky shërbim nuk ofrohet për Shoqëritë Emetuese që kanë më shumë se 1,000 (një mijë) aksionere.
- 1.4 Rregjistruesi është i detyruar që nga momenti i lajmërimit të aksionerëve të Emetuesit për mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve dhe deri në ditën e organizimit të saj të mos bëjë asnjë veprim që lidhet me reflektimin e transaksioneve në Regjistrin e Aksioneve të Emetuesit.
- 1.5 Rregjistruesi, sipas kërkesës së Emetuesit, është i detyruar të kontrollojë nëse gjatë kryerjes së transaksioneve ndonjë aksioner kalon vlerën e (-)% të numrit të përgjithshëm të Aksioneve të Emetuesit të përcaktuar në kërkesën e këtij të fundit.
- 1.6 Kryerja e transaksioneve për transferimin e pronësisë së aksioneve të të tretëve do të bëhet nga Rregjistruesi në përputhje me parashikimet statutores të Emetuesit për këtë qëllim. Gjithashtu, Rregjistruesi është i detyruar t'i bëjë të ditur Emetuesit rregullat e tij për kryerjen e transaksioneve për transferimin e pronësisë.
- 1.7 Rregjistruesi kryen për llogari të Emetuesit të gjitha Shërbimet e parashikuara në këtë Kontratë përkundrejt tarifave përkatëse. Për kryerjen e këtyre shërbimeve nuk është e nevojshme lidhja e kontratave të veçanta, por kryerja e tyre kushtëzohet nga parapagimi i shërbimeve sipas listës së tarifave dhe respektimi i afatit ligjor të kryerjes së tyre nga ana e Rregjistruesit.
- 1.8 I gjithë informacioni i mbajtur nga ana e Rregjistruesit në lidhje me veprimet e kryera nga Emetuesi është në pronësi të Rregjistruesit. Rregjistruesi

detyrohet të ruajë në mirëbesim këtë informacion dhe nuk duhet të pajisë me të asnjë subjekt tjetër apo ta përdorë këtë informacion pa lejen e Emetuesit për ndonjë qëllim tjetër. Shkelja e këtij parashikimi e ngarkon Rregjistruesin me pagimin e të gjitha dëmeve që mund t'i kenë ardhur Emetuesit nga ky veprim.

- 1.9 Rregjistruesi duhet të kujdeset që shërbimet që parashikohen nga kjo kontratë të përmbushen në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat që janë në fuqi gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj kontrate apo ta përshtasë atë (kontratën) me ndryshimet e ligjeve, duke njoftuar për këtë edhe Emetuesin kur Rregjistruesi e konsideron të nevojshme.

II. DETYRIMET E EMETUESIT

- 2.1 Për krijimin dhe mbajtjen e Rregjistrimit të Aksioneve të Emetuesit nga ana e Rregjistruesit Emetuesi është i detyruar të paguajë në momentin e lidhjes dhe firmosjes së kësaj kontrate një tarifë vjetore prej _____ (njetzet e pese mijë) lekë. Në lidhje me shërbimet kryera nga ana e Rregjistruesit, Emetuesi duhet të parapaguajë sipas listës së tarifave të shërbimeve parashikuar në Aneksin 1 të kësaj kontrate. Kjo tarifa mund të ndryshohet me vendim të Këshillit Mbikqyres të Rregjistruesit dhe Rregjistruesi duhet të njoftojë Emetuesin në lidhje me këto ndryshime.

- 2.2 Emetuesi është i detyruar të paraqesë në momentin e lidhjes dhe firmosjes së kësaj kontrate, të gjithë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vendimin e regjistrimit si person juridik
- Vendimin e depozitimit të akteve të Emetuesit në gjykatë;
- Kopje të librit të Aksionerëve të Emetuesit;
- Dokumentacionin e transferimit të aksioneve personave të tretë në qoftë se ka;
- Kopje të notuar të statutit të Emetuesit, pjesa që bën fjalë për aksionet dhe procedurat e transferimit të tyre;
- Vendimin e Këshillit Mbikqyrës për emërimin e Drejtorit, pasi të jetë depozituar në regjistrin tregtar;

- Autorizimin nga ana e Drejtorisë së Emetuesit për personin që do të mbajë marrëdhënjet me Rregjistruesin, nqs ky i fundit nuk është i njëjtë me Drejtorin e Emetuesit;
- Informacione shtesë mbi shoqërinë

Në rast se personi i autorizuar nga Emetuesi përsa u tha më lart e humbet këtë cilësi, Emetuesi është i detyruar të njoftojë me shkrim Rregjistruesin brenda 24 orëve dhe po ashtu duhet të njoftojë edhe emrin dhe detajet e personit të ri të autorizuar.

2.3 Emetuesi njofton Rregjistruesin për datën e mbledhjeve të Asamblesë së Aksionerëve sipas parashikimeve të pikës 1.3 të kësaj kontrate, duke e pajisur Rregjistruesin me informacionin mëposhtëm:

- Datën dhe orën e mbledhjes, vendin ku do mbahet mbledhja si dhe rendin e ditës së mbledhjes;
- Dokumentacionin që do të shqyrtohet në mbledhje nëse dëshiron ta shpërndajë bashkë më njoftimin apo të njoftojë që dokumentacioni mund të tërhiqet pranë Drejtorisë;
- Datën e mbylljes së listës së aksionerëve të vlefshëm për pjesëmarrje në mbledhje.

III. AFATI I KONTRATES, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

3.1 Kjo kontratë lidhet nga data ____ ____ _____ dhe është e vlefshme deri në datën ____ __ ____.

3.2 Me mbarimin e afatit të sipërpërmendur, Emetuesi paraqitet për të lidhur kontratë të re.

3.3 Në rastet kur Emetuesi fillon procedurat e likujdimit vullnetar apo të detyrueshëm ose kur bie në gjendje falimentimi, kjo kontratë vazhdon deri në datën e përfundimit të procedurave të mësipërme. Në këto raste, kontrata

konsiderohet e zgjidhur ndërmjet Likujdatorit ose Administratorit të Falimentimit të Emetuesit dhe Rregjistruesit.

- 3.4 Në rast se Emetuesi bashkohet, ndahet apo transformohet ne çfarëdo lloj forme shoqërie tregtare, kontrata konsiderohet e lidhur deri në datën e miratimit nga QKR (Qendra Kombatare e Regjistrimit) të procedurave të mësipërme. Emetuesi duhet te njoftoje me shkrim regjistruesin ne lidhje me veprimet e mesiperme brenda 5 (pese) ditëve nga data e fillimit të tyre. Moszbatimi i kësaj kërkese nga ana e Emetuesit apo e personit te autorizuar, do t'i ngarkonte ata me pagimin e çfarëdo lloj dëmi të shkaktuar nga ky mos njoftim.
- 3.5 Në qoftë se palët bien dakord të zgjidhin këtë kontratë përpara marrjes fund të saj, atëherë Emetuesi detyrohet t'i paguajë Rregjistruesit tarifën për mbylljen e kontratës sipas tarifave bashkangjitur. Pas kësaj, Rregjistruesi është i detyruar t'i kthejë Emetuesit ekstraktin dhe librin e tij të aksionerëve të datës së mbylljes së kontratës brenda 30 ditëve nga data e zgjidhjes së kontratës.
- 3.6 Nqse palët nuk i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet qe mund te lindin nga kjo kontratë ato mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

IV. HYRJA NE FUQI DHE VLEFSHMERIA E KONTRATES

- 4.1 Kjo kontratë hyn në fuqi dhe bëhet e vlefshme pas nënshkrimit të saj nga palët (referuar pikës 3.1) dhe pasi të jetë përmbushur pika 2.1 e kësaj kontrate.
- 4.2 Kontrata hartohet ne dy kopje të njëjta, një për Emetuesin dhe një për Rregjistruesin, duke u nënshkruar rregullisht prej tyre.

PER RREGJISTRUESIN
DREJTORI
Genard KASTRATI

PER EMETUESIN
DREJTORI
